



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.146

4 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.787, datë 24.9.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.399, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve të përhershëm të Akademisë së Shkencave”	7841
Vendim i BSH nr.65, datë 29.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”	7841
Vendim i BSH nr.67, datë 13.10.2010	Për miratimin e rregullores “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”	7842
Vendim i BSH nr.68, datë 13.10.2010	Për miratimin e udhëzimit “Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive”	7855
Vendim i BSH nr.72, datë 13.10.2010	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive shtesë nga Banka Kombëtare Tregtare sh.a.....	7864
Kërkesë e MPPT nr.1160/4, datë 30.9.2010	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bajram Curri-Dragobi-Cerem”	7865
Kërkesë e MPPT nr.4689/4, datë 30.9.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse Berat” (shtesat).....	7868
Kërkesë e MPPT nr.2842/3, datë 30.9.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”	7869

Kërkesë e MPPT
nr.4095/2, datë 30.9.2010

Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të
paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i
segmentit rrugor “Dublimi i rrugës Fushë-Krujë – Milot”
dhe “Nënkalimi – Fushë-Mamurras”.....

7870

VENDIM
Nr.787, datë 24.9.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.399, DATË 27.3.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË RREGULLT DHE TË ANËTARËVE TË PËRHERSHËM TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.399 datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të rregullt, të anëtarëve të përherëshëm dhe të anëtarëve të asociuar të Akademisë së Shkencave”.

b) Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e asociuar të Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor, për titullin “Akademik i asociuar”, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.65, datë 29.9.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E
SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 47 pika 2 dhe nenit 48 të ligjit nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin nr.43, datë 8.6.2005 dhe ndryshuar me vendimin nr.68, datë 13.9.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në nenin 8, pikat 8.2 dhe 8.3 ndryshojnë si më poshtë:

“8.2 Shoqëria mund të japë kredi me afat mbi 5 (pesë) vjet, vetëm kur shumën e kredisë që do të jepet nuk është më e madhe se:

- 100 për qind të kapitalit, pasi janë zbritur aktivet fikse; ose
- 10 për qind të totalit të depozitave; ose

- 100 për qind të detyrimeve me afat mbi 5 vjet.

Shoqëria përcakton në politikat e saj të brendshme fushat e kreditimit për kreditë me afat mbi 5 (pesë) vjet.”.

“8.3 Shoqëria nuk mund të japë asnjë kredi me afat mbi 10 (dhjetë) vjet.”

2. Në nenin 8, shtohen pikat 8.4 dhe 8.5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“8.4 Shoqëria nuk mund të japë asnjë kredi me afat mbi 5 (pesë) vjet në dy vitet e para të aktivitetit të saj.

8.5 Të gjitha kreditë e dhëna nga shoqëria me një afat mbi 7 (shtatë) vjet duhet të jenë të garantuara me të paktën një nga mjetet e mëposhtme:

- depozitë monetare;

- letra me vlerë të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë;

- garanci të dhëna nga institucione të licencuara ose të specializuara për këtë qëllim;

- pasuri të paluajtshme.”.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për të përgatitur dhe propozuar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU) që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit European dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.67, datë 13.10.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PËRMBAJTJEN E INFORMACIONIT DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË KREDIVE NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, dhe nenit 22 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 127 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Burimeve Njerëzore, si dhe degët e Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja “Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.387, datë 18.7.2007, e ndryshuar, e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI PËRMBAJTJEN E INFORMACIONIT DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË
KREDIVE NË BANKËN E SHQIPËRISË

KREU I
TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushteve dhe kriterëve për njohjen dhe përdorimin e informacionit që administrohet në të.

Neni 2
Qëllimi

Banka e Shqipërisë mban dhe administron Regjistrin e Kredive, me qëllim trajtimin e centralizuar dhe shpërndarjen e informacionit të regjistruar në të, në funksion të ushtrimit të procesit të mbikëqyrjes dhe administrimit optimal të rrezikut të kredisë nga subjektet e mbikëqyrura prej saj.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 1, pika 4 shkronja “a”, nenit 3, paragrafi 2, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 22 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar (këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji “Për Bankën”);
- b) nenit 127 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji “Për bankat”);
- c) ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- d) ligjit nr.9396, datë 12.5.2005 “Për qiranë financiare”, të ndryshuar;
- e) ligjit nr.9630, datë 30.10.2006 “Për faktoringun”;
- f) rregullores “Për kredinë konsumatore dhe hipotekare për individët”, miratuar me vendimin nr.5, datë 11.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; si dhe
- g) rregullores “Për instrumentet e pagesave elektronike”, miratuar me vendimin nr.11 datë 6.2.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

1. Për qëllime të interpretimit dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Regjistri i kredive” ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në nënpikën 44 të pikës I të nenit 4 të ligjit “Për bankat”.

b) “Raportuesit e të dhënave” janë të gjitha bankat, degët e bankave të huaja, dhe subjektet financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që raportojnë informacion/të dhëna në Regjistrin e Kredive. Për qëllime të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë konsiderohet raportuese e të dhënave në Regjistrin e Kredive, për kreditë që i jep punonjësve të saj në përputhje me ligjin “Për Bankën”. Për qëllime të funksionimit të Regjistrit të Kredive, raportues të të dhënave mund të jenë dhe subjekte të tjera financiare, mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura nga Banka e Shqipërisë me to dhe/ose autoritetet e tyre mbikëqyrëse.

c) “Kredi” është marrëdhënia juridike e detyrimit të lindur nga marrëveshja e kredisë, e cila e ekspozon raportuesin e të dhënave ndaj rrezikut të kredisë në kuptim të nenit 61 të ligjit “Për bankat”.

d) “Marrëveshje kredie” është kontrata e lidhur ndërmjet raportuesit të të dhënave dhe klientit, dhe/ose garantuesit të kredisë, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve për livrimin dhe ripagimin e detyrimeve financiare të lindura nga marrëdhënia juridike e kredisë;

e) “Kredimarrës” është klienti ose punonjësi i raportuesit të të dhënave që ka aplikuar apo përfutur kredi nga raportuesit e të dhënave në bazë të një marrëveshjeje kredie të lidhur me ta, si dhe çdo palë tjetër garantuese e marrëveshjes së kredisë.

f) “Të dhëna personale” janë të dhënat e përkufizuara si të tilla në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

g) “Përpunimi i të dhënave” nënkupton të gjitha veprimet në lidhje me marrjen, kontrollin, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave personale dhe informacionit/të dhënave të tjera lidhur me gjendjen e kreditit dhe ekspozimin kreditor të kredimarrësve në sistemin bankar dhe/ose financiar.

h) “Klauzola e pëlqimit paraprak” është autorizimi me shkrim i lëshuar nga kredimarrësi gjatë plotësimit të aplikimit për të përfutur kredi, për përpunimin e të dhënave të kreditit dhe/ose personale të tij/saj në Regjistrin e Kredive.

i) “Informacion negativ” është informacioni në lidhje me vonesën në pagimin nga klienti të kësteve (kryegjësë, kamatave dhe/ose penalteteve) mujore apo të të gjithë kredisë, si dhe çdo formë tjetër shkeljeje e detyrimeve në lidhje me marrëveshjen e kredisë.

j) “Raporti për kredimarrësin” është dokumenti i nxjerrë nga Regjistri i Kredive sipas formatit në aneksin nr.1, i cili përmban të dhëna/informacion mbi identitetin e kredimarrësit dhe gjendjen e kreditit ose ekspozimin e tij kreditor në sistemin bankar dhe financiar.

k) “*Fallback – Recovery*” është procedura e kthimit të sistemit të Regjistrit të Kredive në një situatë normale pasi ka pasur një dështim të funksionimit të sistemit primar.

l) “Sistem backup” është tërësia e *hardware* dhe *software* që shërben në situata emergjente, të jashtëzakonshme, kur sistemi primar del jashtë funksionimit.

m) “SRU” është sistemi raportues i unifikuar, i përbërë nga tërësia e formularëve që raportuesit e të dhënave raportojnë në mënyrë periodike në Bankën e Shqipërisë, me informacion mbi pasqyrat financiare, si dhe tregues të tjerë me karakter rregullativ dhe mbikëqyrës.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura në nenin 3 të saj.

3. Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen në mënyrë specifike në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në fuqi.

Neni 5 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjithë raportuesit e të dhënave, si dhe Banka e Shqipërisë.

Neni 6
Autoriteti përgjegjës

Autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit të Regjistrimit të Kredive është Banka e Shqipërisë.

Neni 7
Parimet e Regjistrimit të Kredive

1. Parimi bazë i funksionimit të Regjistrimit të Kredive është përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave/informacionit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të dhënat personale, të sekretit profesional dhe atij bankar.

2. Regjistri i Kredive funksionon si një shërbim publik dhe sistem për trajtimin e centralizuar dhe shpërndarjen e informacionit që mbahet dhe përpunohet në të. Dokumentet dhe informacioni që shpërndan sistemi i Regjistrimit të Kredive për raportuesit e të dhënave nuk përmbajnë analiza dhe vlerësime për rrezikun e kredisë së kredimarrësve.

3. Të drejtat për njohjen dhe përpunimin e informacionit në sistemin e Regjistrimit të Kredive do të jenë të certifikuara, të autorizuara dhe të regjistruara.

4. Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit dhe të vlerësimit të informacionit dhe dokumenteve që shpërndan Regjistri i Kredive, edhe në rastet kur këto të fundit janë të pasakta ose të paplota si rrjedhojë e raportimit të pasaktë, të paplotë ose për gabime në përpunimin e informacionit nga përdoruesit e saj të autorizuar.

5. Informacioni dhe të dhënat e raportuara në Regjistrin e Kredive mund të transferohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

KREU II
PËRMBAJTJA E INFORMACIONIT

Neni 8
Përmbajtja e informacionit/të dhënave të Regjistrimit të Kredive

1. Në përputhje me rregullat dhe mënyrën e përcaktuar në këtë rregullore, në Regjistrin e Kredive raportohen, mbahen dhe përpunohen të dhëna/informacion në lidhje me identitetin, gjendjen e kreditit dhe ekspozimin kreditor të të gjithë kredimarrësve të raportuesve të të dhënave, për personat e lidhur me ta, si dhe për garantuesit e kredisë.

2. Informacioni i cili raportohet, mbahet dhe shpërndahet në Regjistrin e Kredive, përcaktohet në përputhje me kriteret dhe kategoritë për kreditë, aktivet e tjera, si dhe zërat jashtë bilancit, të parashikuara në rregulloret për administrimin e rrezikut të kredisë, të Bankës së Shqipërisë.

3. Autorizohet administratori përgjegjës të miratojë formatin e të dhënave dhe llojit të informacionit që raportohet në Regjistrin e Kredive.

4. Regjistri i Kredive nuk mban apo trajton të dhëna personale sensitive, me të cilat do të kuptohen të dhëna, të tilla si:

- a) origjina racore dhe etnike, bindjet dhe përkatësitë politike, bindjet fetare dhe të tjera;
- b) gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale.

Neni 9
Të dhëna/informacione që nuk përpunohen në Regjistrin e Kredive

Regjistri i Kredive nuk mban dhe përpunon të dhëna në lidhje me kreditë që:

- a) bankat ose degët e bankave të huaja i japin njëra-tjetrës;
- b) bankat ose degët e bankave të huaja i japin Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;
- c) Banka e Shqipërisë i jep bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja;

d) Banka e Shqipërisë i jep Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në përputhje me kriteret e ligjit “Për bankën”.

Neni 10

E drejta për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin e Regjistrit të Kredive

1. Të drejtën për të njohur, përpunuar dhe përdorur informacionin që raportohet dhe trajtohet në Regjistrin e Kredive e kanë raportuesit e të dhënave dhe përdoruesit e autorizuar të tyre. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore për Regjistrin e Kredive.

2. Kredimarrësit, personat e lidhur me ta, garantuesit e kredive ose trashëgimtarët e tyre kanë vetëm të drejtën të njihen me informacionin që raportohet dhe trajtohet në Regjistrin e Kredive, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore për Regjistrin e Kredive.

3. Të drejtën për të njohur dhe përdorur informacionin që raportohet dhe trajtohet në Regjistrin e Kredive e kanë dhe subjektet e autorizuar me ligj ose institucionet partnere të Bankës së Shqipërisë në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe/ose financiare. Kjo e drejtë ushtrohet në lidhje me respektimin e detyrimit për ruajtjen e sekretit bankar dhe profesional, detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet me institucionet partnere, dhe sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara me akt nënligjor të veçantë.

Neni 11

E drejta e informimit nga raportuesi i të dhënave

1. Kredimarrësi, personat e lidhur me të, garantuesi i kredisë ose trashëgimtarët e tyre kanë të drejtë të kërkojnë nga raportuesi i të dhënave, informacion/të dhëna që ky i fundit mban për të dhe mbi bazën e të cilave nxirret Raporti i Kredimarrësit.

2. Raportuesit e të dhënave duhet të sigurojnë informacionin/të dhënat e kërkuara, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga depozitimi i kërkesës të këta të fundit.

Neni 12

E drejta për të kërkuar rishikimin dhe korrigjimin e informacionit/të dhënave të Regjistrit të Kredive

1. Çdo kredimarrës, personat e lidhur me të, garantuesi i kredisë ose trashëgimtarët e tyre, ka të drejtë të kërkojë rishikimin dhe korrigjimin e informacionit/të dhënave të pasakta ose të paplota që mbahen rreth tij në Regjistrin e Kredive. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me akt nënligjor të veçantë.

2. Të drejtën për të kërkuar rishikimin dhe korrigjimin e informacionit/të dhënave të pasakta ose të paplota e ka edhe Banka e Shqipërisë, sipas parashikimeve të nenit 16 të kësaj rregulloreje.

KREU III

FUNKSIONIMI I REGJISTRIT TË KREDIVE

Neni 13

Mënyra e funksionimit

Regjistri i Kredive administrohet dhe funksionon, në mënyrë që të sigurojë:

a) përqendrimin e informacionit/të dhënave lidhur me ekspozimin kreditor të kredimarrësve, të personave të lidhur me ta, dhe të garantuesve të kredisë, mbi baza individuale dhe/ose të agreguara/të konsoliduara, si dhe shpërndarjen e informacionit të përpunuar të raportuesit e të dhënave për qëllime të vlerësimit të rrezikut të kredisë;

b) sigurimin dhe përpunimin e informacionit në lidhje me ekspozimin kreditor të të gjithë kredimarrësve në sistemin bankar dhe/ose financiar, veçanërisht në lidhje me rrezikun sistematik, duke mbështetur realizimin e funksionit mbikëqyrës dhe rregullator të Bankës së Shqipërisë;

c) përdorimin dhe/ose publikimin e informacionit nga Banka e Shqipërisë për qëllime kërkimore, statistikore dhe qëllime të tjera në shërbim të procesit mbikëqyrës.

Neni 14

Raportimi i të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Të gjithë raportuesit e të dhënave raportojnë në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e përcaktuara sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

2. Informacioni i raportuar në Regjistrin e Kredive nga raportuesit e të dhënave, duhet të jetë në përputhje me informacionin e raportuar sipas SRU.

3. Raportuesit e të dhënave, para se të përpunojnë apo të raportojnë informacionin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë rregullore për qëllime të Regjistrit të Kredive, duhet të autorizohen paraprakisht me shkrim nga kredimarrësi.

4. Autorizimi me shkrim nga kredimarrësi jepet në momentin kur kredimarrësi nënshkruan formularin e aplikimit për kredi, i cili duhet të ketë në tekstin e tij ose bashkëlidhur klauzolën e pëlqimit paraprak. Format i klauzolës së pëlqimit paraprak përcaktohet në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

5. Klauzola e pëlqimit paraprak i bashkëlidhet edhe marrëveshjes së kredisë të lidhur ndërmjet raportuesit të të dhënave dhe kredimarrësit.

6. Klauzola e pëlqimit paraprak është e vlefshme për të gjithë kohën e vlefshmërisë së marrëveshjes së kredisë.

Neni 15

Afatet dhe periodiciteti i raportimit

1. Raportuesit e të dhënave raportojnë në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e parashikuara në formatin e raportimit të të dhënave në Regjistrin e Kredive sipas nenit 8, pika 3, në afatet e mëposhtme:

a) brenda ditës së nesërme të punës të raportuesit të të dhënave, për çdo kontratë kredie të re të lidhur, të livruar, disbursim të ri të kredisë, kredi të paguar dhe kredi të fshirë nga bilanci;

b) brenda ditës së nesërme të punës të raportuesit të të dhënave, për çdo “Letër kredi” ose “Letër garanci” të miratuar dhe të financuar me fondet e raportuesit të të dhënave.

2. Raportuesit e të dhënave raportojnë në Regjistrin e Kredive brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të para të punës të muajit pasardhës, për përditësimin e të dhënave të kredimarrësit, të cilat janë parashikuar si të detyrueshme për raportim, sipas formatit të raportimit të të dhënave në Regjistrin e Kredive, si dhe për gjendjen e portofolit të kredive bashkë me klasifikimet përkatëse.

Neni 16

Përgjegjësia për saktësinë e informacionit dhe të të dhënave

1. Raportuesit e të dhënave janë përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e informacionit dhe të të dhënave të raportuara në bazë të kësaj rregulloreje, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim.

2. Nëse raportuesi i të dhënave zbulon se ndonjë prej informacioneve ose të dhënave të raportuara janë të pasakta ose të paplota, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë duke kryer njëkohësisht korrigjimin e informacioneve/të dhënave të pasakta ose të paplota, dhe duke i raportuar ato përsëri në Regjistrin e Kredive.

3. Nëse Banka e Shqipërisë vëren se informacioni/të dhënat e raportuara apo të mbajtura në Regjistrin e Kredive janë të pasakta apo të paplota, njofton raportuesin e të dhënave. Me marrjen e njoftimit, raportuesi i të dhënave duhet të shpjegojë arsyen e pasaktësisë apo të paplotësisë dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e menjëhershëm të tyre.

4. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë aksesin e raportuesit të të dhënave në Regjistrin nëse ky i fundit nuk merr masat e nevojshme apo nuk zbaton kërkesën e Bankës së Shqipërisë për rishikimin apo korrigjimin e të dhënave të pasakta apo të paplota.

KREU IV KUSHTET DHE MËNYRA E PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT DHE TË TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TË KREDIVE

Neni 17

Përdoruesit e autorizuar të informacionit dhe të të dhënave

Përdoruesit e autorizuar të informacionit dhe të të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive janë:

- a) punonjësit e miratuar të raportuesve të të dhënave;
- b) punonjësit e Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

Neni 18

Miratimi i përdoruesve të autorizuar të raportuesve të të dhënave

1. Banka e Shqipërisë miraton përdoruesit e autorizuar të raportuesve të të dhënave, të parashikuar në nenin 17 shkronja "a" të kësaj rregulloreje.

2. Raportuesi i të dhënave dërgon për miratim pranë Bankës së Shqipërisë kërkesën për miratimin e përdoruesit të autorizuar. Kërkesës i bashkëlidhet formulari i plotësuar sipas aneksit nr.3 të kësaj rregulloreje, duke parashtruar dhe arsyet përkatëse.

3. Kërkesa për miratim mund të refuzohet në rast se gjykohet se ky refuzim i shërben ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit/të dhënave që përmban Regjistri i Kredive. Ky refuzim nuk mund të cenojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e rregullt të sistemit të Regjistrit të Kredive.

Neni 19

Kushtet e marrjes së informacionit dhe të të dhënave nga Regjistri i Kredive

1. Informacioni dhe të dhënat e mbajtura në Regjistrin e Kredive përbëjnë sekret bankar dhe profesional dhe duhen trajtuar dhe ruajtur si të tilla nga të gjithë përdoruesit e autorizuar të tij.

2. Raportuesit e të dhënave, për të dhënat që raportojnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, nuk do të konsiderohen se kanë shkelur detyrimin për ruajtjen e informacionit të klientit, të parashikuar në nenin 125 të ligjit "Për bankat".

3. Përdoruesit e autorizuar dhe/ose raportuesit e të dhënave janë përgjegjës për shkeljen e detyrimit të ruajtjes së informacionit të klientit, të parashikuar në nenin 125 të ligjit "Për bankat", kur e përpunojnë informacionin dhe të dhënat e përfituara nga Regjistri i Kredive në mospërputhje ose jashtë qëllimeve të kësaj rregulloreje.

4. Sistemi i Regjistrit të Kredive siguron kopjen e raportit të kredimarrësit:

- a) për raportuesit e të dhënave, për qëllime të lidhjes, ndjekjes, ristrukturimit dhe përmbushjes së detyrimeve të një marrëveshjeje kredie, në të cilën personi rreth të cilit kërkohet informacioni është palë, person i lidhur me kredimarrësin ose garantues i kredisë;
- b) për kredimarrësit, personat e lidhur me ta, garantuesit e kredisë ose trashëgimtarët e tyre;
- c) në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi gjykate;
- d) për qëllime të tjera, të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 20

Përdorimet e palejueshme të informacionit dhe të të dhënave të Regjistrit të Kredive

Raportuesi i të dhënave dhe/ose përdoruesi i autorizuar i tij ndalohet të marrë, të përpunojë dhe të përdorë informacionin dhe të dhënat e Regjistrit të Kredive, për t'i ofruar ose reklamuar

klientit mundësinë e kredimarrjes, nëse ky subjekt nuk ka aplikuar për marrjen e një kredie me përdoruesin e autorizuar të të dhënave.

Neni 21

Kohëzgjatja e mbajtjes së informacionit dhe e të dhënave në Regjistrin e Kredive

1. Banka e Shqipërisë mban në Regjistrin e Kredive informacionin dhe të dhënat e raportuara, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data në të cilën kredia është raportuar si kredi e paguar ose e fshirë nga bilanci, sipas formatit të raportimit të të dhënave në Regjistrin e Kredive.

2. Pas përfundimit të afatit të lartpërmendur, informacioni dhe të dhënat negative fshihen nga Regjistri i Kredive.

Neni 22

Detyrimet e raportuesve

1. Raportuesit e të dhënave, përpara miratimit të kredisë, kërkojnë informacion dhe të dhëna nga Regjistri i Kredive, për çdo subjekt të interesuar që aplikon për të marrë kredi, si dhe në rastet e ristrukturimit të kredive.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, raportuesit e të dhënave, bazuar në vlerësimin e tyre dhe/ose në rregulla të brendshme të miratuara, mund të kërkojnë informacion edhe për personat e lidhur me kredimarrësin ose garantuesin e kredisë.

3. Në të gjitha rastet, përpara se raportuesit e të dhënave të kërkojnë informacion dhe të dhëna nga Regjistri i Kredive, duhet të jenë autorizuar paraprakisht me shkrim nëpërmjet klauzolës së pëlqimit paraprak nga subjekti për të cilin do të kërkohet informacion apo të dhëna në Regjistrin e Kredive.

4. Raportuesit e të dhënave, nëpërmjet akteve të brendshme, rregullojnë procedurat për marrjen dhe raportimin e informacionit/të dhënave për kredimarrësit e tyre, për korrigjimin e informacionit/të dhënave të pasakta ose të paplota, për mbrojtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme lidhur me përfshirjen e tyre në Regjistrin e Kredive dhe zbatimin e akteve nënligjore përkatëse.

5. Raportuesit e të dhënave marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e informacionit/ të dhënave që raportojnë në Regjistrin e Kredive nga dëmtimet apo përdorimet e paautorizuara.

Neni 23

Masat ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje nga raportuesit e të dhënave, merr masat ndëshkimore të parashikuara në ligjin “Për bankat”. Për raportuesit e të dhënave që nuk janë subjekte të ligjit “Për bankat” do të aplikohen sanksionet që parashikojnë marrëveshjet përkatëse.

2. Do të konsiderohen shkelje të kësaj rregulloreje, përveç të tjerash, veprimet e mëposhtme:

a) mosdërgimi i informacionit dhe i të dhënave brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore;

b) raportimi i informacionit ose i të dhënave që dihet se janë të pasakta ose të rreme;

c) përdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi i informacionit dhe i të dhënave;

d) përdorimi i informacionit në kundërshtim me nenin 20 të kësaj rregulloreje;

e) shkelja e sekretit/konfidencialitetit dhe/ose zbulimi i paautorizuar i informacionit/të dhënave;

f) mosrespektimi i afatit 10-ditor lidhur me të drejtën e informimit, përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje;

g) mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në nenin 16 të kësaj rregulloreje, në lidhje me korrigjimin e të dhënave të pasakta apo të paplota;

h) raportimin e të dhënave jo në përputhje me SRU, sipas pikës 2 të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

3. Marrja e masave ndëshkimore nga Banka e Shqipërisë ndaj raportuesve nuk përjashton përgjegjësinë civile apo penale, të parashikuar në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 24

Tarifat për përdorimin e informacionit dhe të të dhënave të Regjistrimit të Kredive

1. Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor tarifën për përdorimin e informacionit dhe të të dhënave, që mbahen në Regjistrimin e Kredive.

2. Banka e Shqipërisë realizon faturimin mujor për raportuesit, lidhur me detyrimet e tyre për përdorimin e shërbimeve të Regjistrimit të Kredive.

3. Faturimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni kryhet mbi bazën e numrit të kërkimeve të suksesshme të muajit, sipas dëftësive të debitit dhe të tarifës së miratuar nga Banka e Shqipërisë për çdo kërkesë të kryer nga raportuesit. Faturat përkatëse i dërgohen çdo muaj raportuesit.

4. Subjektet financiare jobanka, brenda datës 15 të muajit pasardhës, derdhen në llogarinë e Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë, pranë bankave ose degëve të bankave të huaja, shumën përkatëse të faturës sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Pagesa e tarifës për nxjerrjen e raportit të kredimarrësit kryhet nga subjekti i regjistrimit. Kjo pagesë kryhet në favor të Bankës së Shqipërisë pranë bankave ose degëve të bankave të huaja, në llogaritë e përcaktuara në sistemet përkatëse të pagesave me përshkrimin “Komisione për Regjistrimin e Kredive”.

6. Tarifat janë subjekt i rishikimit periodik nga Banka e Shqipërisë.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Testimi i procedurave të *Fallback Recovery* në sistemin e Regjistrimit të Kredive *backup*

1. Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike testimin e procedurave të saj të *Fallback Recovery* për ngjarjet e paparashikuara në bashkëpunim dhe me raportuesit e tjerë të sistemit të Regjistrimit të Kredive.

2. Banka e Shqipërisë njofton raportuesit e të dhënave për kalimin e të dhënave të sistemit të Regjistrimit të Kredive primar në sistemin e Regjistrimit të Kredive *backup*, për zhvillimin e testimit të procedurave të *Fallback Recovery*, si dhe për çdo veprim që ata duhet të ndërmarrin, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune para datës së testimit.

Neni 26

Procedurat operacionale dhe administrimi i brendshëm i Regjistrimit të Kredive

Banka e Shqipërisë nxjerr aktet e nevojshme nënligjore, ndërmjet të tjerash, në lidhje me:

a) funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat e brendshme operacionale për administrimin e sistemit të Regjistrimit të Kredive.

b) procedurat për nxjerrjen e raportit për kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrim.

Neni 27

Përgjegjësia në rastin e forcave madhore

1. Raportuesit në sistem nuk mbajnë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, që vijnë si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, të luftërave, të 7850

demonstratave, turbullirave të tjera civile, fatkeqësive natyrore dhe për çdo rrethanë tjetër jashtë kontrollit të tyre, si dhe si pasojë e çdo force tjetër madhore.

2. Raportuesi që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta për shkaqet e përcaktuara në pikën 1:

a) duhet të njoftojë Bankën e Shqipërisë me shkrim mbi shkakun dhe shkallën që e ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve;

b) duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt që të jetë e mundur dhe njëkohësisht, të përpiqet të minimizojë efektet negative të shkaqeve të përcaktuara në pikën 1.

Neni 28 Publikimet

Banka e Shqipërisë mund të përpunojë dhe publikojë informacionin dhe të dhënat e mbajtura në Regjistrin e Kredive për qëllime kërkimore, statistikore dhe në shërbim të procesit mbikëqyrës, mbi baza të konsoliduara dhe duke garantuar anonimatën e tyre, pa veçuar raportues të dhënash ose kredimarrës të caktuar.

Neni 29 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSI 1 RAPORTI PËR KREDIMARRËSIN

Të dhëna të përgjithshme

Emri, atësia, mbiemri	Datëlindja	Nr. i dokumentit të identifikimit	
Personi juridik			
Emri i personit	Data e regjistrimit	Numri i regjistrimit	Statusi ligjor
Data e regjistrimit të parë në Regjistrin e Kredive		Adresa	Nr. telefoni

Në raportuesin (emri i raportuesit që kryen kërkimin në Regjistër):

Lloji i kredisë	Data e disbursimit*	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
Historiku i klasifikimit								
Kolaterali 1		Numri serial		Lloji i kolateralit		Përshkrimi i kolateralit		
Kolaterali 2		Numri serial		Lloji i kolateralit		Përshkrimi i kolateralit		
Historiku i klasifikimit								
Kolaterali 1		Numri serial		Lloji i kolateralit		Përshkrimi i kolateralit		
Kolaterali 2		Numri serial		Lloji i kolateralit		Përshkrimi i kolateralit		

Në raportuesit e tjerë:

Lloji i Kredisë	Data e disbursimit*	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
Historiku i klasifikimit								
Kolaterali 1		Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Kolaterali 2		Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Historiku i klasifikimit								
Kolaterali 1		Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Kolaterali 2		Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			

* Radhitja e kredive të akorduara do të prezantohet sipas datës më të fundit të disbursimit, domethënë do të radhitet e para kredia e disbursuar në datën më të fundit.

Ekspozimi i kredimarrësit në sistem (në lekë):

Numri total i kredive	Shuma totale e aprovuar	Shuma totale e disbursuar	Shuma totale e kësteve mujore	Teprica totale e kredisë	Shuma totale e vonuar

Kredimarrësi si person i lidhur:

Në raportuesin/at XXX:

Roli	Lloji i kredisë	Data e Disbursimit*	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar	Monedha	Statusi i klasifikimit
Historiku i klasifikimit									
Kolaterali 1			Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Kolaterali 2			Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Historiku i klasifikimit									
Kolaterali 1			Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			
Kolaterali 2			Numri serial		Lloji i kolateralit	Përshkrimi i kolateralit			

Madhësia totale e ekspozimit të kredimarrësit në sistem, përfshirë dhe kreditë, në të cilat ai shfaqet si person i lidhur (në lekë)

Numri total i kredive	Shuma e aprovuar	Shuma e disbursuar	Kësti mujor	Teprica e kredisë	Shuma e vonuar

Pesë kërkimet më të fundit mbi kredimarrësin:

Data e kryerjes së kërkimit	Emri i raportuesit

Shënime të tjera.

ANEKSI 2
KLAUZOLA E PËLQIMIT PARAPRAK

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij aplikimi, deklaroj se i gjithë informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar, si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se banka (emri i bankës) /dega (emri i bankës së huaj) /subjekti (emri i institucionit kredidhënës) dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme:

Autorizoj bankën (emri i bankës) /degën e (emri i bankës së huaj) /subjektin (emri i institucionit kredidhënës) që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies sime kontraktore të kredisë me bankën (emri i bankës) /degën (emri i bankës së huaj) / subjektin (emri i institucionit kredidhënës); dhe/ose

3. Vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit; të njihet me detyrimet e mia ndaj bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrin të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që banka (emri i bankës) /dega (emri i bankës së huaj) /subjekti (emri i institucionit kredidhënës); të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Qyteti (fshati), data (dd.mm.vvvv)

Emër, mbiemër

Nënshkrimi



ANEKSI 3
BANKA E SHQIPËRISË
REGJISTRI I KREDIVE

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES

Ju lutem plotësoni këtë formular për të krijuar një përdorues të ri ose për të ndryshuar profilin e një përdoruesi ekzistues.

Për:

Banka e Shqipërisë
Departamenti i Mbikëqyrjes

Nga raportuesi: _____

Data e kërkesës: ___/___/___
(dd/mm/vvvv)

Përdoruesve të mëposhtëm u jepen të drejtat në sistem sipas tabelës:

Emri/mbiemri i përdoruesit	Ngarkon të dhëna	Kërkon informacion
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Për raportuesin

Autorizuesi i kërkesës

(_____)

Për Bankën e Shqipërisë

Autorizuesi i kërkesës

(_____)

VENDIM
Nr.68, datë 13.10.2010

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR PROCEDURËN E NXJERRJES SË RAPORTIT
MBI KREDIMARRËSIN DHE RISHIKIMIN E TË DHËNAVE QË MBAHEN NË
REGJISTRIN E KREDIVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c” dhe “f”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 127 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 26 të rregullores “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin “Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive” dhe anekset e tij, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Burimeve Njerëzore, si dhe degët e Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet udhëzimi “Për procedurën e nxjerrjes së raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive”, miratuar me vendimin nr.71, datë 18.7.2007, i ndryshuar, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

UDHËZIM

**PËR PROCEDURËN E NXJERRJES SË RAPORTIT MBI KREDIMARRËSIN DHE RISHIKIMIN
E TË DHËNAVE QË MBAHEN NË REGJISTRIN E KREDIVE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës për nxjerrjen e raportit mbi kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive.

Neni 2
Baza ligjore

Ky udhëzim nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe shkronjës “b” të nenit 26 të rregullores

“Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.67, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3 Përkufizime

1. Për qëllime të interpretimit dhe zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Rregullorja” është rregullorja “Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.67, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

b) “Ligji “Për bankën” është ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

c) “Ligji “Për bankat” është ligji nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

d) “Kërkues” është sipas rastit vetë kredimarrësi, personat e lidhur me të ose trashëgimtarët e tyre, si dhe subjekte të tjera që gëzojnë të drejtën për të kërkuar raportin për kredimarrësin në bazë të një detyrimi ligjor apo vendimi të gjykatës kompetente. Fjalët “kërkues”, “kredimarrës” dhe “subjekt” në këtë udhëzim përdoren në mënyrë alternative, sipas kontekstit.

e) “Dokumente shoqëruese” janë dokumentet, mbi bazën e të cilave kryhet identifikimi i kërkuesit dhe të cilat i bashkëlidhen kërkesës që i drejtohet Bankës së Shqipërisë për nxjerrjen e raportit për kredimarrësin ose rishikimin e të dhënave.

f) “Punonjës i autorizuar” është punonjësi i Zyrës së Regjistrit të Kredive në Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me ata të përkufizuar në aktet e përmendura në nenin 2 të këtij udhëzimi.

KREU II PROCEDURA PËR NXJERRJEN E RAPORTIT PËR KREDIMARRËSIN ME KËRKESËN E TIJ

Neni 4 Kërkesa për raportin e kredimarrësit

1. Banka e Shqipërisë nxjerr raportin për kredimarrësin mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga vetë ky i fundit, nga trashëgimtarët e tij apo nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre. Banka e Shqipërisë nxjerr raportin për kredimarrësin dhe mbi bazën e kërkesës së paraqitur drejtpërdrejt nga personat e lidhur me kredimarrësin, garantuesi/t e kredisë, nga trashëgimtarët e tyre ose nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre.

2. Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm për trajtimin e kërkesës së kredimarrësit, përcaktohen në aneksin 1 të këtij udhëzimi.

3. Në rastin kur kërkesa paraqitet nga trashëgimtarët, asaj duhet t’i bashkëngjitet në çdo rast dhe dëshmia e trashëgimisë, e cila vërteton cilësinë e trashëgimtarit.

4. Formulari i kërkesës mund të merret pa pagesë pranë Bankës së Shqipërisë në zyrat e saj qendrore, në degët e saj ose mund të shkarkohet pa pagesë nga faqja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë.

5. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm dorëzohen pranë Bankës së Shqipërisë në zyrat e saj qendrore ose në degët e saj.

Neni 5 Pranimi i kërkesës dhe nxjerrja e raportit

1. Kërkesa e kredimarrësit do të konsiderohet e pranuar nga Banka e Shqipërisë nëse ajo paraqitet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore dhe në këtë udhëzim.

2. Punonjësi i autorizuar përpunon kërkesën e kredimarrësit nëse ky i fundit ka dorëzuar kërkesën, mandatpagesën e tarifës dhe dokumentet e tjera shoqëruese të domosdoshme për shqyrtimin e saj.

3. Nëse punonjësi i autorizuar ka dyshime në lidhje me identitetin e kredimarrësit ose të personit që ka paraqitur kërkesën, punonjësi mund të kërkojë edhe dokumente të tjera ligjore, të cilat konfirmojnë identitetin e tij. Në këtë rast, kërkesa quhet e pranuar dhe mund të përpunohet, vetëm pasi janë paraqitur dokumentet shtesë të identifikimit.

4. Punonjësi i autorizuar duhet të nxjerrë raportin për kredimarrësin, bazuar në kërkesën e mësipërme brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data kur kërkesa konsiderohet e pranuar. Raportit për kredimarrësin i bashkëlidhet edhe informacioni në lidhje me mënyrën se si duhet të lexohet raporti dhe procedurën për trajtimin e kërkesave për rishikimin e të dhënave.

5. Në rastet kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues sillet nga degët e Bankës së Shqipërisë dhe është e paplotë ose e pasaktë, ose punonjësi i autorizuar ka dyshime në lidhje me identitetin e kredimarrësit, punonjësi i autorizuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kërkesës, njofton me telefon dhe/ose e-mail degën përkatëse, duke i kërkuar dokumente të tjera shtesë.

6. Me marrjen e njoftimit, dega duhet të njoftojë brenda një dite pune kredimarrësin për dokumentacionin e kërkuar, dhe me plotësimin ose saktësimin e dokumentacionit ta dërgojë atë pranë Zyrës së Regjistrimit të Kredive.

Neni 6

Tërheqja e raportit nga kredimarrësi

1. Pas nxjerrjes së raportit, punonjësi i autorizuar njofton me telefon subjektin për datën kur ai mund të tërheqë raportin e kërkuar.

2. Tërheqja e raportit mund të kryhet pranë zyrave qendrore të Bankës së Shqipërisë ose në degën më të afërt të Bankës së Shqipërisë ku subjekti ka paraqitur kërkesën.

3. Për tërheqjen e raportit, kredimarrësi duhet t'i paraqesë punonjësit të autorizuar kopje të dokumenteve që vërtetojnë identitetin e tij, së bashku me kërkesën e dorëzuar për nxjerrjen e raportit.

4. Nëse kredimarrësi nuk paraqitet në datën kur është njoftuar nga punonjësi i autorizuar për tërheqjen e raportit, Banka e Shqipërisë ruan raportin edhe për 10 (dhjetë) ditë pune nga data e mësipërme. Më pas, punonjësi i autorizuar e bën të pavlefshëm raportin dhe e shkatërron duke e grisur.

KREU III

PROCEDURA PËR NXJERRJEN E RAPORTIT PËR KREDIMARRËSIN NË PËRMBUSHJE TË NJË DETYRIMI LIGJOR APO TË NJË VENDIMI GJYKATE

Neni 7

Paraqitja e kërkesës dhe nxjerrja e raportit të kredimarrësit

1. Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues i nevojshëm për trajtimin e kërkesës për nxjerrjen e raportit të kredimarrësit në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi të gjykatës kompetente, përcaktohen në aneksin 1 të këtij udhëzimi.

2. Marrja e formularit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, si dhe dorëzimi i tyre në Bankën e Shqipërisë, kryhet sipas pikave 4 dhe 5 të nenit 4 të këtij udhëzimi.

3. Pas paraqitjes së kërkesës, Banka e Shqipërisë vlerëson mundësinë e nxjerrjes së raportit, duke respektuar detyrimin për ruajtjen e sekretit bankar dhe profesional sipas ligjit “Për bankat” dhe ligjit “Për Bankën”, si dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet me institucionet partnere në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe/ose financiare.

4. Kërkesa sipas pikës 1 të këtij neni konsiderohet e pranuar në momentin kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues janë paraqitur të plota dhe të sakta, si dhe nëse Banka e Shqipërisë ka vlerësuar pozitivisht mundësinë e nxjerrjes së raportit.

5. Punonjësi i autorizuar duhet të nxjerrë raportin sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data kur kërkesa konsiderohet e pranuar.

Neni 8

Tërheqja e raportit për kredimarrësin

Pas nxjerrjes së raportit, në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi të gjykatës kompetente, Banka e Shqipërisë i dërgon zyrtarisht subjektit që ka paraqitur kërkesën për raportin e kredimarrësit, ose punonjësi i autorizuar njofton me telefon përfaqësuesin e tij për datën kur ai mund të tërheqë raportin.

KREU IV

PROCEDURA PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE TË KREDIMARRËSIT

Neni 9

Rishikimi i të dhënave me kërkesë të kredimarrësit

1. Për verifikimin e pretendimeve të kredimarrësit lidhur me saktësinë dhe/ose plotësinë e të dhënave/informacionit që mbahet për të në Regjistrin e Kredive, dhe/ose për të kryer rishikimet/ndryshimet e nevojshme që rrjedhin nga verifikimi, vetë kredimarrësi ose një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tij, mund të paraqesë një kërkesë në Bankën e Shqipërisë.

2. Kërkesa për verifikimin dhe/ose rishikimin e të dhënave/informacionit, që mbahet për ta në Regjistrin e Kredive, mund të paraqitet edhe nga personat e lidhur me kredimarrësin, garantuesi/t e kredisë, nga trashëgimtarët e tyre. Kërkesa mund të paraqitet drejtpërdrejt nga personat e lidhur me kredimarrësin, garantuesi/t e kredisë, nga trashëgimtarët e këtyre të fundit ose nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tyre.

3. Në rastin kur kërkesa paraqitet nga trashëgimtarët, asaj duhet t'i bashkëngjitet në çdo rast dhe dëshmia e trashëgimisë, e cila vërteton cilësinë e trashëgimtarit.

4. Format i kërkesës përcaktohet në aneksin 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Format i kërkesës mund të merret pa pagesë pranë Bankës së Shqipërisë, në zyrat e saj qendrore apo në degët e saj, ose mund të shkarkohet pa pagesë nga faja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë.

6. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues dorëzohen në zyrat qendrore të Bankës së Shqipërisë ose në degët e saj.

Neni 10

Procedura për trajtimin e kërkesës për rishikimin e të dhënave

1. Punonjësi i autorizuar fillon procedurën për trajtimin e kërkesës për rishikimin e të dhënave/informacionit, brenda 1 (një) dite pune nga data e pranimit të kërkesës.

2. Kërkesa e kredimarrësit do të konsiderohet e pranuar nga Banka e Shqipërisë kur kërkuesi ka dorëzuar përveç kërkesës edhe kopje të dokumenteve që ka dorëzuar sipas dokumentacionit shoqërues në aneksin 1, të domosdoshëm për shqyrtimin e saj.

3. Punonjësi i autorizuar fillon trajtimin e kërkesës duke kontaktuar menjëherë nëpërmjet e-mail-it dhe/ose një forme tjetër të komunikimit, raportuesin e të dhënave, duke i kërkuar verifikimin e të dhënave/informacionit të cilat pretendohen nga kredimarrësi se janë të pasakta dhe/ose të paplota. Raportuesi i të dhënave duhet të kryejë verifikimin përkatës brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data që i është komunikuar kërkesa për këtë qëllim nga punonjësi i autorizuar.

4. Afati i përcaktuar në pikën më sipër, mund të zgjatet me vetëm 3 (tri) ditë pune, nëse raportuesi i të dhënave paraqet në Bankën e Shqipërisë një arsye të pranueshme për zgjatjen e afatit.

5. Nëse nga verifikimi i kryer konstatohet se të dhënat/informacioni për kredimarrësin janë të pasakta ose të paplota, raportuesi i të dhënave duhet menjëherë t'i korrigjojë ato dhe t'ia dërgojë informacionin e rishikuar punonjësit të autorizuar.

6. Me marrjen e informacionit të korrigjuar, punonjësi i autorizuar, brenda ditës së nesërme të punës, duhet të njoftojë mbi informacionin e rishikuar çdo raportues të të dhënave, i cili ka marrë kopje të mëparshme të pasakta apo të paplota të raportit.

7. Punonjësi i autorizuar njofton kredimarrësin apo personin e autorizuar prej tij, për të tërhequr kopjen e rishikuar të raportit brenda 3 (tri) ditësh pune nga data në të cilën ka marrë informacionin e korrigjuar.

8. Nëse pas verifikimit të kryer nga raportuesi i të dhënave, informacioni i cili kërkohet të rishikohet është i saktë dhe kredimarrësi bie dakord me të, atëherë informacioni i raportit për kredimarrësin nuk ndryshon.

9. Nëse pas verifikimit të kryer nga raportuesi i të dhënave, ky i fundit konfirmon sërish se informacioni është i saktë, ndërsa kredimarrësi pretendon përsëri se informacioni është i pasaktë apo i paplotë, atëherë raporti nuk ndryshon, por kredimarrësi ka të drejtë të dorëzojë pranë Zyrës së Regjistrit të Kredive një dokument me shkrim, në të cilin të parashtrijë në mënyrë të përmbledhur arsyet e këtij pretendimi.

10. Arsyet e pretenduara në dokumentin e parashikuar në pikën 9 të këtij neni, i bashkëlidhen informacionit të mbajtur në Regjistrin e Kredive dhe e bashkëshoqërojnë atë në çdo rast të trajtimit të tij.

Neni 11

Regjistri i kërkesave për rishikimin e të dhënave

1. Zyra e Regjistrit të Kredive mban një regjistër në të cilin evidentohen të gjitha kërkesat e dorëzuara për nxjerrjen e raportit të kredimarrësit dhe rishikimin e të dhënave.

2. Regjistri i kërkesave evidenton gjithashtu veprimet e punonjësit të autorizuar të Bankës së Shqipërisë për trajtimin e kërkesës, veprimet e ndërmarra nga Raportuesi i të Dhënave në lidhje me trajtimin e kërkesës, dhe rezultatin e arritur në fund të procedurës.

3. Informacioni në lidhje me kërkesat për raportin e kredimarrësit dhe rishikimin e të dhënave sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mbahet në regjistër për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Neni 12

Masat në rast të mostrajtimit të kërkesës për rishikimin e të dhënave

1. Nëse raportuesi i të dhënave, pa dhënë ndonjë arsye të vlefshme, nuk verifikon saktësinë dhe plotësinë e të dhënave që kërkohen të rishikohen sipas kërkesës së punonjësit të autorizuar dhe brenda afatit të parashikuar në këtë udhëzim, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të pezullojë aksesin e këtij raportuesi të dhënash në Regjistrin e Kredive.

2. Pezullimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni mund të zgjasë për aq kohë sa raportuesi i të dhënave nuk përmbush detyrimet e parashikuara në këtë udhëzim për verifikimin e saktësisë dhe plotësisë së të dhënave.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Tarifa për përpunimin e të dhënave të Regjistrit të Kredive

1. Kërkuesi paguan tarifën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për përpunimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive. Kërkuesi nuk paguan tarifë për kërkesën për rishikimin e të dhënave.

2. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë janë të përjashtuar nga detyrimi për pagesën e tarifës për nxjerrjen e Raportit të Kredimarrësit.

3. Tarifa paguhet në çdo sportel të bankave ose të degëve të bankave të huaja, në favor të llogarisë së Regjistrit të Kredive në Bankën së Shqipërisë.

4. Mandatpagesa e tarifës së parashikuar në pikën 3 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën të dhënat e përcaktuara në aneksin 3 të këtij udhëzimi. Kopja e mandatpagesës i bashkëngjitet kërkesës për nxjerrjen e Raportit të Kredimarrësit.

5. Këto tarifa do të transferohen nëpërmjet sistemeve të pagesave, nga bankat ose degët e bankave të huaja në përfitim të Bankës së Shqipërisë. Transferimi do të kryhet në llogaritë e përcaktuara në aneksin 3.

6. Tarifa mund të ndryshojë pa paralajmërim, në përputhje me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

7. Banka e Shqipërisë bën publike në çdo kohë tarifën e mësipërme.

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Për të mundësuar trajtimin e kërkesës suaj, formularit të mësipërm ju lutemi t'i bashkëlidhni edhe kopje të dokumenteve të mëposhtme:

A. Kur kërkesa është për raportin e kredimarrësit të një individi apo personi fizik

1. Një kopje të noterizuar të pasaportës ose letërnjoftimit të subjektit të të dhënave ose një fotokopje të pasaportës ose letërnjoftimit kur kjo kryhet nga punonjësi i autorizuar në Bankën e Shqipërisë, si dhe një dokument brenda afatit të tij të vlefshmërisë që të përmbajë edhe atësinë e subjektit të të dhënave.

2. Në rast se subjekti i të dhënave nuk zotëron një pasaportë ose letërnjoftim, atëherë Banka e Shqipërisë, nëse e gjykon të mjaftueshme, mund të kërkojë një kopje të një dokumenti tjetër të subjektit të të dhënave, nga i cili mund të nxirren të dhëna për identitetin e tij (si për shembull të lejes së drejtimit të automjetit ose librezë/fatura për pagimin e shërbimeve utilitare etj.).

3. Në rast se kërkesa dorëzohet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, atëherë përveç dokumenteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 më lart, duhet të dorëzohet edhe një prokurë origjinale apo autorizim i posaçëm, i lëshuar nga subjekti i të dhënave për personin e autorizuar, si dhe një kopje të një dokumenti identifikimi të këtij të fundit.

B. Kur kërkesa është për Raportin e Kredimarrësit të një personi juridik

1. Një kopje të noterizuar të “Ekstraktit historik të Regjistrimit Tregtar” ose origjinalin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

2. Një kopje të dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor/administratorit të personit juridik, që paraqet kërkesën në emër të këtij të fundit;

3. Në rast se kërkesa paraqitet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, asaj i bashkëngjitet dhe një prokurë origjinale apo autorizim i posaçëm, të dhëna për personin e autorizuar nga organi kompetent i personit juridik, si dhe një kopje e një dokumenti identifikimi të këtij të fundit.

C. Kur kërkesa vjen në përmbushje të një detyrimi ligjor apo të një vendimi të gjykatës kompetente

1. Një kopje të dokumentit apo aktit në të cilin përcaktohet detyrimi ligjor apo vendimi i gjykatës kompetente në të cilin kërkohet raporti për kredimarrësin për një subjekt të caktuar, dhe në të cilin shpjegohet arsyeja përse kërkohet raporti.

2. Një autorizim të posaçëm origjinal dhënë kërkuesit për raportin e kredimarrësit.



BANKA E SHQIPËRISË
REGJISTRI I KREDIVE
ANEKSI 2

FORMULARI I KËRKESËS PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE

Ju lutem shkruani qartë me shkronja të mëdha shtypi informacionin e kërkuar në hapësirën përkatëse. Plotësimi i këtij formulari është i nevojshëm për trajtimin e kërkesës suaj. Gjithashtu, bashkëlidhni me këtë kërkesë një kopje të dokumenteve shoqëruese të listuara më poshtë, të cilat janë të nevojshme për identifikimin tuaj nga Regjistri i Kredive për çdo kërkesë. Ju do të merrni nga ne brenda 15 ditësh një përgjigje në lidhje me depozitimin e kërkesës suaj për rishikimin e të dhënave. Nëse brenda dy javësh nuk merrni asnjë njoftim, ju lutem telefononi në numrat: 04 2419301; 04 2419302; 04 2419303.

Për:	Banka e Shqipërisë, Regjistri i Kredive, sheshi "Skënderbej", nr.1, Tiranë, Shqipëri.	Vetëm për përdorim zyrtar të BSH
Nga:	Emri, atësia, mbiemri i kërkuarit Nr.pasaporte/certifikatë lindjeje/letërnjoftimi/kartë identiteti Datëlindja: Adresa e vendbanimit: Nr. i telefonit:	Nr. reference: Data e pranimit: Punonjësi i autorizuar: Veprimi i kryer:
Dëshiroj të kërkoj rishikimin e kopjes së bashkëlidhur të raportit të kredimarrësit për subjektin e mëposhtëm (shënoni emrin e subjektit si në raportin e kredimarrësit): <input type="checkbox"/> Jam subjekti i mësipërm <input type="checkbox"/> Veproj në emër të subjektit dhe marrëdhënia ime me të është: <input type="checkbox"/> Veproj në emër të personit juridik me: Emri i personit juridik Numri i regjistrimit Data e regjistrimit Statusi ligjor (Sh.a. Sh.p.k. etj.)		
Ju lutem shënoni informacionin për të cilin kërkon rishikim dhe bashkëlidhni dokumentet për të mbështetur kërkesën tuaj. Shpjegim i detajuar i kërkesës sime është si më poshtë: (Mund të bashkëlidhni faqe shtesë nëse hapësira nuk është e mjaftueshme/		
Nënshkrimi: _____	Data: _____	

Ky formular mund të merret pa pagesë nga faqja zyrtare e internetit të BSH-së <http://www.bankofalbania.org/regjistikredive> ose pranë ambienteve të BSH-së në Tiranë. Ju lutem dorëzoheni këtë formular dorazi në ndërtesën qendrore të BSH-së në Tiranë në adresën e shënuar në formular. Mos e dërgoni nëpërmjet e-mailit apo me postë. Ju lutem bashkëlidhni gjithashtu një kopje të raportit të kredimarrësit në të cilin përfshihet informacioni për të cilin kërkon rishikim.

ANEKSI 3

MANDATPAGESA E TARIFËS PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT TË KREDIVE NGA SUBJEKTI I TË DHËNAVE/KREDIMARRËSI

1. Banka urdhëruese	Emri dhe kodi BIC i bankës urdhëruese
2. Klienti urdhërues	Emër, mbiemër i klientit urdhërues / adresa
3. Datë valuta	dd/mm/vvvv (data, muaji, viti)
4. Shuma e pagesës	xxx ALL
5. Banka përfituese	Banka e Shqipërisë (Kodi BIC-STANALTR)
6. Llogaria përfituese (IBAN)	AL88 1011 1008 0000 0000 7777 777L Regjistri i Kredive, BSH
7. Përshkrimi i pagesës	Për sa derdhur/urdhëruar nga (emër, atësi, mbiemër i klientit ose përfaqësuesit ligjor të tij (kërkues i raportit të kredimarrësit) tarifa për nxjerrje raporti të kredimarrësit nga Regjistri i Kredive.

VENDIM

Nr.72, datë 13.10.2010

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHITESË NGA BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54 pika 2 shkronja, “b”, “d” “dh”, nënpika “v”, “vi”, “vii”, “e”, “ë” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Kombëtare Tregtare sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:
 - Factoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare;
 - Marrjen e angazhimeve;
 - Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe si vijon:
 - letra me vlerë të transferueshme;
 - instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;
 - pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu dhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;
 - Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
 - administrimin e aktiveve të tilla, administrimi i parave dhe i portofolit, administrimin e fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;

- shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;

- sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar, si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të, nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;

- Shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive; kujdestar i letrave me vlerë të qeverisë;”.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

KËRKESË
Nr.1160/4, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes public, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bajram Curri-Dragobi-Cerem”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që vlerësimi i pasurisë tokë, është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik””.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “proces regjistrimi” në tekstin e publikimit, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtyre procedurave.

Për pronarët për të cilët është bërë shënimi “pa konfirmuar” në tekstin e publikimit, të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 2 366 056 (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BAJRAM CURR - DRAGOBI CEREM"

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	Z.K	NR.PAS.			Vlera lekë	Vlefte për dru- frutorët	Vlefte totale në lekë	Lloji i pasurisë	SHËNIME
						Sip. që preket	Çmimi m ²					
1	Rustem	Sulejman	Gjyriqi	1347	38/1/1	67	2500	167500		167500	Arë	Konfirmuar ZRPP
2	Astrit	Haxhi	Gjyriqi	2593	531	522	206	107532		107532	Arë	Konfirmuar ZRPP
3	Astrit	Ali	Matoshi	2593	539	233	206	47998	62000	109998	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
4	Halil	Met	Bisheva	2593	521/1	60	206	12360	51000	63360	Pemëtore	Proces regjistrimi
5	Isa	Skender	Bisheva	2593	522/5	27	206	5562		5562	Arë	Konfirmuar ZRPP
6	Hajri	Miftar	Bisheva	2593	522/6	16	206	3296		3296	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
7	Adem	Sadik	Bala	2593	522/2	25	206	5150	96000	101150	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
8	Izmail	Sadik	Bala	2593	522/1	29	206	5974	29000	34974	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
9	Isa	Skender	Bisheva	2593	514/3	130	206	26780		26780	Arë	Konfirmuar ZRPP
10	Hajri	Miftar	Bisheva	2593	514/4	153	206	31518		31518	Arë	Konfirmuar ZRPP
11	Ram	Niman	Sellaj	2593	514/5	48	206	9888		9888	Arë	Konfirmuar ZRPP
12	Sali	Niman	Sellaj	2593	514/7	55	206	11330		11330	Arë	Konfirmuar ZRPP
13	Halil	Brahim	Sellaj	2593	514/8	108	206	22248		22248	Arë	Konfirmuar ZRPP
14	Miftar	Sokol	Dardha	2593	516/1	184	206	37904		37904	Arë	Proces regjistrimi
15	Mal	Rexhep	Dardha	2593	510/1	149	206	30694		30694	Arë	Proces regjistrimi
16	Agron	Muharrem	Bala	2593	515/2	33	206	6798		6798	Arë	Konfirmuar ZRPP
17	Adem	Sadik	Bala	2593	515/17	103	206	21218		21218	Arë	Konfirmuar ZRPP
18	Izmail	Sadik	Bala	2593	515/18	15	206	3090		3090	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
19	Beqir	Sadik	Bala	2593	515/30	28	206	5768		5768	Arë	Konfirmuar ZRPP
20	Hajredin	Ram	Arifaj	2593	515/31	22	206	4532		4532	Arë	Proces regjistrimi
21	Halil	Ali	Arifaj	2593	515/33	27	206	5562		5562	Arë	Konfirmuar ZRPP
22	Elez	Ali	Arifaj	2593	515/34	21	206	4326		4326	Arë	Konfirmuar ZRPP
23	Met	Ali	Arifaj	2593	515/35	34	206	7004		7004	Arë	Konfirmuar ZRPP
24	Ibrahim	Sejdi	Zhanaj	2593	515/36	73	206	15038		15038	Arë	Konfirmuar ZRPP
25	Rifat	Rexh	Ahmataj	2593	642/2	49	206	10094		10094	Arë	Konfirmuar ZRPP
26	Dem	Ali	Osmanaj	2593	160/1	230	206	47380		47380	Arë	Konfirmuar ZRPP
27	Ilmi	Halil	Sellaj	2593	160/7	191	206	39346		39346	Arë	Konfirmuar ZRPP
28	Sali	Niman	Sellaj	2593	160/8	87	206	17922		17922	Arë	Konfirmuar ZRPP
29	Ram	Niman	Sellaj	2593	160/9/1	90	206	18540		18540	Arë	Konfirmuar ZRPP
30	Agim	Sherif	Malsia	2593	160/10	187	206	38522		38522	Arë	Proces regjistrimi
31	Xheme	Sadri	Ramaj	2593	160/11	265	206	54590		54590	Arë	Konfirmuar ZRPP

32	Nale	Rexhep	Dardha	2593	498/5	136	206	28016		28016	Arë	Konfirmuar ZRPP
33	Nale	Rexhep	Dardha	2593	498/6	151	206	31106		31106	Arë	Konfirmuar ZRPP
34	Besmir	Sadri	Mekshiqi	2593	531/5/1	260	206	53560		53560	Arë	Konfirmuar ZRPP
35	Zenel	Uk	Mekshiqi	2593	531/5/3	249	206	51294		51294	Arë	Proces regjistrimi
36	Fejzi	Mustaf	Mekshiqi	2593	531/5/4	191	206	39346		39346	Arë	Konfirmuar ZRPP
37	Guxim	Mustaf	Mekshiqi	2593	531/5/8	91	206	18746		18746	Arë	Konfirmuar ZRPP
38	Fejzi	Mustaf	Mekshiqi	2593	530/11/4	364	206	74984		74984	Arë	Proces regjistrimi
39	Qazim	Mehmet	Musaj	2593	531/2	55	206	11330		11330	Arë	Proces regjistrimi
40	I pa identifikuar			2593	531/5	225	206	46350		46350		Te pa konfirmuar
41	I pa identifikuar			2593	531/6	100	206	20600		20600		Te pa konfirmuar
42	I pa identifikuar			2593	532	145	206	29870		29870		Te pa konfirmuar
43	I pa identifikuar			2593	515/3/2	145	206	29870		29870		Te pa konfirmuar
44	Brahim	Halil	Gelaj	2170	79	286	160	45760		45760	Arë	Konfirmuar ZRPP
45	Selim	Abdulla	Mucaj	2170	78	159	160	25440		25440	Arë	Proces regjistrimi
46	Mehmet	Ali	Mucaj	2170	69	107	160	17120		17120	Arë	Proces regjistrimi
47	Murat	Ali	Mucaj	2170	60	96	160	15360		15360	Pemëtore	Konfirmuar ZRPP
48	Syl	Shaban	Mucaj	2170	42	87	160	13920		13920	Arë	Proces regjistrimi
49	Avni	Shpend	Mucaj	2170	16	94	160	15040		15040	Arë	Proces regjistrimi
50	Idriz	Halil	Mucaj	2170	8	55	160	8800		8800	Arë	Konfirmuar ZRPP
51	Muharrem	Halil	Mucaj	2170	5	202	160	32320		32320	Arë	Proces regjistrimi
52	I pa identifikuar			2170	171/1	280	160	44800		44800	Arë	Të pa konfirmuar
53	I pa identifikuar			2170	97/1	596	160	95360		95360	Arë	Të pa konfirmuar
54	I pa identifikuar			2170	59/1	29	160	4640		4640	Arë	Të pa konfirmuar
55	I pa identifikuar			2170	51	110	160	17600		17600	Arë	Të pa konfirmuar
56	I pa identifikuar			2170	40	70	160	11200		11200	Arë	Të pa konfirmuar
57	I pa identifikuar			2170	138/3	343	160	54880		54880	Arë	Të pa konfirmuar
58	I pa identifikuar			2170	102	189	160	30240		30240	Arë	Të pa konfirmuar
59	I pa identifikuar			2170	95/2	458	160	73280		73280	Arë	Të pa konfirmuar
60	I pa identifikuar			2170	103	649	160	103840		103840	Arë	Të pa konfirmuar
61	I pa identifikuar			2170	110/2	398	160	63680		63680	Arë	Të pa konfirmuar
62	I pa identifikuar			2170	63	237	160	37920		37920	Arë	Të pa konfirmuar
63	I pa identifikuar			2170	62	368	160	58880		58880	Arë	Të pa konfirmuar
64	I pa identifikuar			2170	61	609	160	97440		97440	Arë	Të pa konfirmuar
	TOTALI					10795		2128056	238000	2366056		

KËRKESË
Nr.4689/4, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse Berat” (shtesat).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që vlerësimi i pasurisë tokë, është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik””.

Pronari për të cilin është bërë shënimi “Rikonfirmim”, do të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të jetë bërë rikonfirmimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE BERAT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.Pas.	Lloji i pas.	Sip. Shpron. (m ²)	Çmimi (lekë/ m ²)	Shuma (lekë)	Shuma totale (lekë)	Shënime
1	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/170	Truall	30	3100	93000	93000	Konf.ZVRPP
2	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/12	Truall	170	3100	527000	527000	Rikonfirmim
3	Çelnik	Hetem	Shuli	8501	2/172	Truall	79	3100	244900	244900	Konf.ZVRPP
	Shuma								864900	864900	

KËRKESË
Nr.2842/3, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Oldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RRETHI VLORË
BASHKIA VLORË

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA RRUGA
“TRANSBALLKANIKE”, VLORË

Lloji i pasurisë së patundshme: truall

Nr.	Pronari	Nr.pas.	ZK	TRUALL			Shënime
				Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlefte në lekë	
1	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/114	8605	428	12000	5136000	Konfirmuar nga ZRPP
2	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/119	8605	837	12000	10044000	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/5	8605	174	12000	2088000	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/62	8605	246	12000	2952000	Konfirmuar nga ZRPP
5	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/40	8605	889	12000	10668000	Konfirmuar nga ZRPP
6	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/10	8605	135	12000	1620000	Konfirmuar nga ZRPP
7	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/11	8605	109	12000	1308000	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali			2818		33816000	

KËRKESË
Nr.4095/2, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Dublimi i rrugës Fushë-Krujë – Milot” dhe “Nënkalimi – Fushë-Mamurras” (kultura bujqësore dhe drufrutorë), sipas tekstit dhe listës që i bashkëngjitet kësaj shkrese.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Vlerësimet për kulturat dru frutorë dhe dru dekorativ janë bërë nga drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit të qarqeve Durrës dhe Lezhë.

Listat e pasurive që preken nga ky shpronësim janë hartuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.961, datë 18.9.2009 dhe nr.64, datë 3.2.2010 “Për shpronësimin e sipërfaqeve tokë bujqësore dhe truall”.

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 11 034 403 (njëmbëdhjetë milionë e tridhjetë e katër mijë e katërqind e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "NËNKALIMI FUSHË - MAMURRAS"

PASURITË: KULTURA BUJQËSORE, DRU FRUTORË DHE VRESHT
KOMUNA MILOT
BASHKIA: MAMURRAS
FSHATI: FUSHË - MAMURRAS

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Kultura Bujqësore Dru frutorë Vl. (Lekë)	Vresht Vl. (Lekë)	Shuma (Lekë)	Shënime
1	AHMET	GANI	ZANI	1676	157/16	114230	36050	150280	Konfirmuar nga ZVRPP
2	RAMAZAN	LIMAN	ISHMAKU	1676	157/18	228000		228000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	REXHEP	GANI	ZANI	1676	157/15	86500	66218	152718	Konfirmuar nga ZVRPP
4	ARVIN	GANI	ZANI	1676	157/14	42700		42700	Konfirmuar nga ZVRPP
5	ARVIN	GANI	ZANI	1676	157/17	195500	73608	269108	Konfirmuar nga ZVRPP
6	ISLAM	XHEMALI	ALIU	1676	157/19	45000		45000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	HYSANI	DYL	BICI	1676	200/3	48000	20587	68587	Konfirmuar nga ZVRPP
8	(B.Pron.) Bakie Adem		FERA	1676	200/1	67200	172943	240143	Konfirmuar nga ZVRPP
9	HAJDAR	MET	MAXHALAKU	1676	201/1	20597		20597	Konfirmuar nga ZVRPP
10	REXHEP	ISLAM	HASANAJ	1676	158/52; 158/54	120600	85380	205980	Konfirmuar nga ZVRPP
11	IDRIZ	ISLAM	HASANAJ	1676	158/50	78000	72858	150858	Konfirmuar nga ZVRPP
12	ISLAM	HASAN	HASANAJ	1676	158/46	156300		156300	Konfirmuar nga ZVRPP
13	PETRIT	DEDE	STOJANI	1676	158/64	7600	14705	18970	Konfirmuar nga ZVRPP
14	ZENEL	HASAN	HASANAJ	1676	158/63	21000		21000	Konfirmuar nga ZVRPP
15	VESEL	IDRIZ	HASANAJ	1676	158/51; 158/55	49000		49000	Konfirmuar nga ZVRPP
16	BEQIR	IDRIZ	HASANAJ	1676	158/76	56000		56000	Konfirmuar nga ZVRPP
17	HASAN	ISLAM	HASANAJ	1676	158/47	108500		108500	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI (Lekë)					1444727	542349	1987076	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS " THUMANË - MILOT"

PASURITË : KULTURA BUJQËSORE, DRU-FRUTORË DHE VRESHT
KOMUNA MILOT
BASHKIA: MAMURRAS
FSHATI: FUSHË - MAMURRAS

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Kultura Bujqësore	Vresht	Shuma (Lekë)	Shënime
						Dru frutorë Vl. (Lekë)			
1	AVNI	RUSTEM	PEPA	1676	212/14/1	48000		48000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	KOL	BIB	ZIRA	1676	213/19/1; 213/20/1	219000		219000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	ZEF	PREN	BUÇA	1676	92/2	14700		14700	Konfirmuar nga ZVRPP
4	ESAT	HAJDAR	DEMA	1676	106/4	19500		19500	Konfirmuar nga ZVRPP
5	GJON	BARDHOK	BAÇUKU	1676	155/9	27000		27000	Konfirmuar nga ZVRPP
6	GJON	BARDHOK	BAÇUKU	1676	155/12;155/6	31500	75000	106500	Konfirmuar nga ZVRPP
7	GJON	BARDHOK	BAÇUKU	1676	155/2	34000	372020	406020	Konfirmuar nga ZVRPP
8	MARTIN	MARK	PERKEQI	1676	216/20	68500		68500	Konfirmuar nga ZVRPP
9	ARTAN	GJON	BAÇUKU	1676	156/7	36000		36000	Konfirmuar nga ZVRPP
10	PJETER	MARK	PERKEQI	1676	208/7	74500		74500	Konfirmuar nga ZVRPP
11	PASHK	BIB	ZIRA	1676	213/22/1	3400		3400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	SHPETIM	ALI	GOCI	1676	74/11	12400		12400	Konfirmuar nga ZVRPP
13	SABRI	BAKI	SELA	1676	87/4	10350		10350	Konfirmuar nga ZVRPP
14	PRENG	NDUE	SHANI	1676	87/6	5200		5200	Konfirmuar nga ZVRPP
15	ISLAM	ALI	MAXHALAKU	1676	87/7	800		800	Konfirmuar nga ZVRPP
16	ISLAM	HASAN	HASANI	1676	92/4;108/5; 158/46	17200		17200	Konfirmuar nga ZVRPP
17	ISLAM	HASAN	HASANI	1676	108/24	85000		85000	Konfirmuar nga ZVRPP
18	EDI	LIRI	XHEKA	1676	92/16	128900		128900	Konfirmuar nga ZVRPP
19	KADRI	MEHMET	DEMA	1676	108/9	5850		5850	Konfirmuar nga ZVRPP
20	ZENEL	HASAN	HASANI	1676	108/7;158/48	21120		21120	Konfirmuar nga ZVRPP
21	SALI	HAJDAR	DEMA	1676	108/8	10400		10400	Konfirmuar nga ZVRPP
22	HASAN	ISLAM	HASANI	1676	108/23;108/6;158/47	40000	66003	106003	Konfirmuar nga ZVRPP
23	ALI	IDRIZ	HASANI	1676	108/25;108/4	12600		12600	Konfirmuar nga ZVRPP
24	ALI	IDRIZ	HASANI	1676	158/49	132000		132000	Konfirmuar nga ZVRPP
25	VESEL	IDRIZ	HASANI	1676	108/2;158/51;158/55	132000		132000	Konfirmuar nga ZVRPP
26	REXHEP	ISLAM	HASANI	1676	158/52;108/1;158/54	280000		280000	Konfirmuar nga ZVRPP

27	MUHARREM	ISUF	LIKA	1676	155/3	85000		85000	Konfirmuar nga ZVRPP
28	LEKE	PAL	BAÇUKU	1676	155/7;155/8	12000		12000	Konfirmuar nga ZVRPP
29	ISLAM	XHEMALI	ALIU	1676	158/68; 157/19	24800	9668	34468	Konfirmuar nga ZVRPP
30	KUJTIM	XHEMAL	ALIU	1676	158/45	37000		37000	Konfirmuar nga ZVRPP
31	(B. Pron.) Bakie Adem	FERRA		1676	200/1	10000		10000	Konfirmuar nga ZVRPP
32	ALFRED	AQIF	BASHA	1676	202/2	169800		169800	Konfirmuar nga ZVRPP
33	GANI	LIMAN	ZANI	1676	157/17; 157/14	7900		7900	Konfirmuar nga ZVRPP
34	ALEKSANDER	PJETER	PERKEQI	1676	216/22	14500		14500	Konfirmuar nga ZVRPP
35	PRENG	ZEF	HANI	1676	216/6	52400		52400	Konfirmuar nga ZVRPP
36	REXHEP	GANI	ZANI	1676	157/15	76000		76000	Konfirmuar nga ZVRPP
37	NDUE	PASHK	BIBA	1676	70/25	2360		2360	Konfirmuar nga ZVRPP
38	ADEM	BEQIR	GOCI	1676	71/22	12250		12250	Konfirmuar nga ZVRPP
39	ISHE	AQIF	JAURI	1676	204/15	6500	5000	11500	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI (LEKË)					1980430	527691	2508121	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "MBIKALIMI BUSHNESH"

PASURITË : KULTURA BUJQËSORE, DRU-FRUTORË DHE VRESHT

KOMUNA MILOT
KOMUNA: THUMANË
FSHATI: BUSHNESH

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Numri pasurisë	Kultura bujqësore dru frutorë	Vresht	Shuma (Lekë)	Shënime
						Vl. (Lekë)	Vl. (Lekë)		
1	GJERGJ	NDUE	KOLA	1332	72/26	82348	30582	112930	Konfirmuar nga ZVRPP
2	HASAN		MYRTA	1332	70/3	85485	27061	112546	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI (Lekë)					167833	57643	225476	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "THUMANË - MILOT"

PASURITË: KULTURA BUJQËSORE, DRU-FRUTORË DHE VRESHT
KOMUNA: MILOT
FSHATI: SHULLAZ

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Numri Pasurisë	Kultura Bujqësore	Vresht	Shuma (Lekë)	Shënime
						Dru frutorë	VL. (Lekë)		
1	MARK	GEG	GJETA	3441	6/31	12000		12000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	MEHILL	NDUE	NDRECA	3441	6/32	10500		10500	Konfirmuar nga ZVRPP
3	NDRE	ZEF	BROZI	3441	6/47; 6/51	85500		85500	Konfirmuar nga ZVRPP
4	GJETE	NDUE	GJETA	3441	6/50	3600		3600	Konfirmuar nga ZVRPP
5	FROK	GJETE	BROZI	3441	9/42	52500		52500	Konfirmuar nga ZVRPP
6	DEDE	PRENG	BROZI	3441	9/45	165000		165000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	AGIM	HASAN	SUFA	3441	10/23	46500		46500	Konfirmuar nga ZVRPP
8	DODE	GJETE	LASKA	3441	13/14	12000		12000	Konfirmuar nga ZVRPP
9	DERVISH	HASAN	LAMA	3441	13/5	199500		199500	Konfirmuar nga ZVRPP
10	KOL	GJETE	LASKA	3441	13/15	30000		30000	Konfirmuar nga ZVRPP
11	RAMAZAN	ISUF	HIDRI	3441	14/1; 14/3	70500		70500	Konfirmuar nga ZVRPP
12	PJETER	DEDE	SEFGJINI	3441	76/28	13500		13500	Konfirmuar nga ZVRPP
13	HAMDI	RAMAZAN	LAMA	3441	10/12	6000		6000	Konfirmuar nga ZVRPP
14	SKENDER	SHUAIP	ANXHAKU	3441	3/21	13500		13500	Konfirmuar nga ZVRPP
15	GJERGJ	MARK	SEFGJINI	3441	76/9	84000		84000	Konfirmuar nga ZVRPP
16	DEDE	MARK	SEFGJINI	3441	76/27	6800	75000	81800	Konfirmuar nga ZVRPP
17	(B.Pr.) Gjin Pal Doda, Preng Pal Doda			3441	76/25	49600	85346	134946	Konfirmuar nga ZVRPP
18	ALI	RAMAZAN	TAFILI	3441	77/12	49500		49500	Konfirmuar nga ZVRPP
19	BUJAR	RAMAZAN	TAFILI	3441	78/10	22500		22500	Konfirmuar nga ZVRPP
20	XHEVIT	RAMAZAN	TAFILI	3441	78/12	73500		73500	Konfirmuar nga ZVRPP
21	ISUF	RAMAZAN	TAFILI	3441	78/13	60000		60000	Konfirmuar nga ZVRPP
22	NIKOLL	DEDE	NDRECA	3441	3/13; 6/37	39650	21003	60653	Konfirmuar nga ZVRPP
23	MEHILL	GJIN	DODA	3441	77/20	72000	24377	96377	Konfirmuar nga ZVRPP
24	PRENG	PJETER	GJETA	3441	9/38	20000		20000	Konfirmuar nga ZVRPP
25	PRENG	PJETER	GJETA	3441	9/38	7500		7500	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI (LEKË)					1205650	205726	1411376	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "THUMANË - MILOT"

PASURITË: KULTURA BUJQËSORE, DRU-FRUTORË, VRESHT DHE DRU DEKORATIVE
KOMUNA MILOT
KOMUNA: THUMANË
FSHATI: THUMANË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Kultura bujqësore	Vresht	Shuma (Lekë)	Shënime
						Dru frutorë			
						VI. (Lekë)	VI. (Lekë)		
1	ALFRED	FADIL	RRYÇI	3599	32/3/2	46800	23493	70293	Konfirmuar nga ZVRPP
2	ZENEL		DIKA	3599	3/10	64800	35573	100373	Konfirmuar nga ZVRPP
3	VELI		KEQI	3599	3/4	85300	28325	113625	Konfirmuar nga ZVRPP
4	PETRIT		JANGOZI	3599	89/5	12600		12600	Konfirmuar nga ZVRPP
5	BASHKIM		JANGOZI	3599	89/8	47000		47000	Konfirmuar nga ZVRPP
6	FEJZULLA		CAKA	3599	3/7	3000		3000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	ISLAM	RAMAZAN	RRYÇI	3599	35/35	41000		41000	Konfirmuar nga ZVRPP
8	(B.Pron.)		JANGOZI	3599	35/33	243200	15662	258862	Konfirmuar nga ZVRPP
9	NEZIR		JANGOZI	3599	35/30	89600	15662	105262	Konfirmuar nga ZVRPP
10	OSMAN	ZENEL	DIKA	3599	3/1	100000	33157	133157	Konfirmuar nga ZVRPP
11	HAJRIE		FRESKU	3599	4/21	4320		4320	Konfirmuar nga ZVRPP
12	DAVE		ALIU	3599	4/26	245000	2100	247100	Konfirmuar nga ZVRPP
13	XHEMAL		ALIU	3599	4/24	60400	6996	67396	Konfirmuar nga ZVRPP
14	HASAN		ALIU	3599	4/25	297400	23493	320893	Konfirmuar nga ZVRPP
15	VESEL		JANGOZI	3599	89/16;	107900		107900	Konfirmuar nga ZVRPP
16	RAM		JANGOZI	3599	89/6	42300	6996	49296	Konfirmuar nga ZVRPP
17	ALI	HAJDAR	MUZHAQI	3599	28/7/1	181600	61566	243166	Konfirmuar nga ZVRPP
18	XHEMAL		JANGOZI	3599	89/17	162400	47653	210053	Konfirmuar nga ZVRPP
19	(B.Pron.) Zenel Ahmet		RRYÇI	3599	28/6/1	41400	20494	61894	Konfirmuar nga ZVRPP
20	BAJRAM		DANI	3599	28/12; 28/11	277600	10903	288503	Konfirmuar nga ZVRPP
21	IDRIZ		JANGOZI	3599	89/10	105500	31991	137491	Konfirmuar nga ZVRPP
22	MUHARREM		MANA	3599	89/20	9240		9240	Konfirmuar nga ZVRPP
23	HASAN		MANA	3599	89/19	21432		21432	Konfirmuar nga ZVRPP
24	KASEM		DANI	3599	22/2	75980	17496	93476	Konfirmuar nga ZVRPP
25	NEVRUZ		RRYÇI	3599	32/14	36181		36181	Konfirmuar nga ZVRPP
26	XHEMAL	DERVISH	MIRDITA	3599	89/22	85800		85800	Konfirmuar nga ZVRPP
27	BERAM		DELIU	3599	66/18	18830		18830	Konfirmuar nga ZVRPP
28	IDRIZ		JANGOZI	3599	89/18	34115		34115	Konfirmuar nga ZVRPP

29	VESEL		KEQI	3599	66/10	66600	17496	84096	Konfirmuar nga ZVRPP
30	(B.Pr.) Petrit MARKU		F. Bushnesh	1332	72/11	94500		94500	Konfirmuar nga ZVRPP
31	(B.Pr.) Blerim, Mentor Rryçi			3599	32/35		D- Dek.188500	188500	Konfirmuar nga ZVRPP
32	(B.Pr.) Blerim, Mentor Rryçi F.Thumane			3599	32/36		D-Dek.111200	111200	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTALI (Lekë)						2701798	698756	3400554	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E FERMERËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "THUMANË - MILOT"

PASURITË: KULTURA BUJQËSORE, DRU-FRUTORË, DRU DEKORATIVË DHE VRESHT
KOMUNA MILOT
BASHKIA: LAÇ
FSHATRAT: FSHATI LAÇ; GJOREM (ISH - N.B)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Kultura Bujqësore	Dru dekorative	Shuma (Lekë)	Shënime
						Dru frutorë	Vl.(Lekë)		
1	KASTRIOT	PASHK	DOÇI	2365	355/49	81000		81000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	LULJETA	PASHK	DOÇI	2365	355/50	54000		54000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	(B. Pron.) Prend Dede	LLESHI		2365	1/13	56000		56000	Konfirmuar nga ZVRPP
4	DEDE	GJOK	SYZIU	2365	2/12	16000		16000	Konfirmuar nga ZVRPP
4	PRENG	MARK	SYZIU	2365	3/9	10000		10000	Konfirmuar nga ZVRPP
5	PRENE	MARK	SYZIU	2365	2/11	18000		18000	Konfirmuar nga ZVRPP
6	(B. Pron.) Prene Bib	GJONAJ		2365	14/9	10000		10000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	NDUE	MARK	DOÇI	2365	355/3	16000		16000	Konfirmuar nga ZVRPP
8	SANDER	PRENG	NEZHA	2365	12/1;	82300		82300	Konfirmuar nga ZVRPP
9	PRENG	PJETER	KROSI	2365	12/14	39200	Vresht 34500	73700	Konfirmuar nga ZVRPP
10	VIKTOR	GJON	KROSI	2365	13/9	19200		19200	Konfirmuar nga ZVRPP
11	PRENG	KOL	NEZHA	2365	13/1	41400		41400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	LENA	PRENG	LALA	1768	46/16/1	12800		12800	Konfirmuar nga ZVRPP
13	GJON	DOD	RICA	1768	59/34/2	2500	192000	194500	Konfirmuar nga ZVRPP
14	MARTE	GJON	NIKOLLI	1768	59/30/1	31500		31500	Konfirmuar nga ZVRPP
15	MARK	PJETER	GJOKA	1768	46/22/1; 46/21/1	7400		7400	Konfirmuar nga ZVRPP
16	BESNIK	DERVISH	LIKA	1768	11/2/1	34200		34200	Konfirmuar nga ZVRPP
17	DEDE	GJOK	SYZIU	2365	2/12	16000		16000	Konfirmuar nga ZVRPP
18	PAULIN	NIKOLL	KAÇORI	1768	59/10/1	16800		16800	Konfirmuar nga ZVRPP
19	SIMON	NDUE	LAMA	1768	59/26/1		230000	230000	Konfirmuar nga ZVRPP
20	ARJAN	SADIK	ALLAMANI	1768	89/17/2		220000	220000	Konfirmuar nga ZVRPP
21	NIKOLL	GJERGJ	GJEÇI	1768	89/14/2		40000	40000	Konfirmuar nga ZVRPP
22	NDUE	MARK	ZEFI	2365	355/17		221000	221000	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTALI (Lekë)						564300	937500	1501800	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 2.11.2010

Doli nga shtypi më 4.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë